



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror
Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit
Mbledhja nr. 17
Prishtinë, më 21.4.2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-2

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Danush Ademi, Agim Aliu, Doruntinë Maloku, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Nezir Çoçaj, Donika Kadaj-Bujupi.

Munguan: Fatmir Limaj dhe Milena Miliçević.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Zahir Çerkini-praktikant në Kuvend; Hasan Preteni-AKK; Blerim Kelmendi-AKK; Artan Canhasi-KDI; Florina Merovci-ZPRK; Petrit Hysaj-OSBE; Valdet Hajdini-IKD; Mejreme Tahirukaj-Radio Kosova; Lorik Bajrami-Çohu; Altin Ademi; Dibran Istrefi-Klan Kosova; Beadin Sylja-Kosovapress; Nebih Maxhuni-Radio Dukagjini; Amire Qamili-BIRN; Avni Bytyqi-GLPS.

Nga Stafi i Komisionit: Visar Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.3.2015;
3. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, për vitin 2014;
4. Shqyrtimi i raportit të Komisionit nga vizita në QK-Lipjan;
5. Caktimi i një përfaqësuesi në Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish- të Dënuarve dhe të ish- të Përndjekurve Politikë;

6. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

***Kryetarja** propozoi që pika katër e rendit të ditës, të hiqet dhe konstatoi se rendi i ditës u miratua me këtë ndryshim.*

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 17.3.2015

Kryetarja konstatoi se procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 17.3.2015, u miratua pa vërtetje.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor të punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, për vitin 2014

Kryetarja, theksoi se ndonëse janë ndërtuar mekanizma të shumtë për luftimin e korrupsionit dhe krimit të organizuar, ende kemi probleme me këtë dukuri. Gjithashtu, theksoi se ndonëse raporti i punës së AKK-së ka shumë statistika, ende nuk kemi pasur veprime konkrete të prokurorisë.

Hasan Preteni, theksoi se sa i përket punës së agjencisë, ka pasur përmirësime në legjislacionin nga i cili buron puna e agjencisë. Që nga 1 janari 2015, mosdeklarimi i pasurisë dhe deklarimi i rrejtshëm i pasurisë, janë vepra penale. Gjatë vitit të kaluar, agjencia ka pranuar 248 informata, 56 kanë qenë të bartura nga viti i kaluar. Që nga qershori i viti të kaluar, asnjë zyrtar nuk ka përcjellë asnjë informacion në zyrat e agjencisë, por 124 raste janë hetuar nga ana e agjencisë, sipas detyrës zyrtare. Gjatë vitit 2014, kemi 131 kallëzime penale, 102 raste të mbyllura, 56 në procedurë, raste të deleguara për shkelje administrative tek institucionet e tjera 4. Struktura e veprave penale të trajtuara nga agjencia, janë keqpërdorimi i detyrës zyrtare ose autoritetet zyrtar, ushtrimi i ndikimit, mashtrimi në detyrë, përvetësimi në detyrë, marrja ryshfetit, mosraportimi i pasurisë apo raportimi i rrejtshëm. Ai e konsideroi si hendikep të punës së agjencisë mospublikimin e emrave të zyrtarëve të hetuar nga ana e prokurorisë. Nga të gjitha rastet që janë dërguar në prokurori, vetëm 22% e tyre janë hedhur poshtë në mungesë provash. Ne kemi përcjellë 91 raste për mosdeklarim të pasurisë dhe kemi vetëm 12 aktgjykime për to. Në vazhdim, foli edhe për monitorimin e Strategjisë dhe Planit të veprimit kundër korrupsionit 2013-2017, i përcjellë me raportimet kumulative njëvjeçare. Tani jemi duke e rishikuar këtë plan të veprimit, sepse është obligim i agjencisë që në gjysmën e realizimit të këtij plani, të bëjë një analizë, të rishikojë, të vlerësojë rrezikun dhe të identifikojë detyrat për përudhen e ardhshme. Deri më 1 korrik, do të kemi planin e veprimit të rishikuar për përudhen e ardhshme sipas strategjisë. Tutje, foli për deklarimin e pasurisë dhe dhuratave, parandalimin e konfliktit të interesit, duke dhënë statistika për institucionet e vendit. Kurse funksionet shumëfishta i prezantoi si problem, ku janë identifikuar 1509 zyrtarë të lartë të cilët ushtrojnë apo mbajnë dy e

më shumë funksione. Duke folur rreth raportit, shpalosi edhe aktivitete të tjera si fushatat sensibilizuese me EULEX-in, për projektet e përfituara, raportin me mediat dhe komunikimi me shoqërinë civile. Në vazhdim, tha se fusha më e ndjeshme mbetet ajo e prokurimit publik, ku përfshihet mosrespektimi i ligjit në të gjitha fazat nga përgatitja, publikimi, vlerësimi, lidhja e kontratës dhe zbatimi. Nga 67 opinionet, institucionet kanë vepruar në 64 raste, kurse në 3 raste nuk është marrë parasysh opinioni i agjencisë.

Në fund ai rekomandoi që mos të këtë ndryshime të shpeshta të legjislacionit, pa një analizë të mirëfilltë, krijimi i bazës së përbashkët të të dhënave, metodologji e përbashkët hetuese, trajnime të përbashkëta, vlerësim i performancës së titullarëve të institucioneve kundër-korrupsion dhe publikimi i aktakuzave dhe aktgjykimeve.

Kryetarja, parashtoi pyetjet: Pse ju si agjenci nuk i paraqitni sfidat që ju i keni gjatë ushtrimit të veprimtarisë suaj pranë Komisionit për Legjislacion? Pse asnjëherë nuk keni bërë analiza mes të hyrave që marrin zyrtarët e lartë publikë dhe pasurisë që e kanë? A ka qasje agjencia në xhirollogaritë bankare të zyrtarëve të lartë? Çka ndodhë në rastet kur ka dyshime që një zyrtar i lartë, pasurinë e fituar në mënyrë të jashtëligjshme e ka dërguar jashtë vendit?

Gjithashtu, theksoi se në formularët e deklarimit të pasurisë, gjithmonë janë vërejtur lëshime dhe gabime të mëdha, qoftë të natyrës teknike apo natyrave të tjera. Po ashtu, ajo theksoi se kemi vërejtje kur jemi të bashkëpunimi i agjencisë me organizatat joqeveritare që përcjellin agjendat kundër-korrupsion. Në lidhje me rastin e emërimit të koordinatorit të bisedimeve me Serbinë nga ana e delegacionit kosovar, ajo parashtoi pyetjen: Çka ka bërë agjencia në këtë rast? Gjithashtu, ajo ngriti çështjen edhe të z.Blerand Stavilecit, me pretendimin se ka konflikt interesi në funksionet që ai ushtron. Si dhe, çfarë është bërë me rastin e këshilltarit politik të Kryeministrit të Kosovës, kur dihet se ushtron edhe profesionin e avokatit.

Armend Zemaj, theksoi se krijimi i mekanizmave të shumtë për luftimin e korrupsionit, ende nuk është bërë punë konkrete në këtë drejtim, dhe se, sfida mbetet funksionimi i tërë sistemit të drejtësisë, duke pasur parasysh që zinxhiri institucional nuk funksionon si duhet kur kemi të bëjmë me këtë dukuri. Andaj, në këtë rrjedhë diskutimi, parashtoi pyetjen: Cili është raporti i agjencisë me Prokurorinë e Shtetit?

Selviqe Halimi, kërkoi nga ana e agjencisë se ashtu si është duke e bërë punën deri më tani, me anë të deklaratave publike për korrupsion, të vazhdoni edhe më tej punën tuaj dhe të kërkonin nga Komisioni për Legjislacion, që të ngrenë zërin që puna juaj kur të adresohet në prokurori, puna e tyre të jetë më efektive. Gjithashtu, ajo kërkoi nga ana e agjencisë që me shkrim të sjellin kërkesat e tyre në lidhje me plotësim-ndryshimet e ligjeve, të cilat afektojnë në punën tuaj si institucion.

Doruntinë Maloku, për drejtorin e agjencisë, parashtroi pyetjen: Në cilin institucion të Republikës së Kosovës keni hasur më shumë në vepra korruptuese?

Agim Aliu, theksoi se kur kemi të bëjmë me shifrat dhe të dhënat që ofrohen nga raportet kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me veprat korruptive në Kosovë dhe kur shohim se janë ngritur vetëm 47 aktakuza për shtatë vite të punës së agjencisë, vërejmë një diskrepancë të madhe në lidhje me luftimin e kësaj dukurie. Andaj, si rrjedhojë e kësaj, lind pyetja se a ka staf profesional të mjaftueshëm brenda agjencisë për ta bërë hetimin dhe luftimin e korrupsionit, apo organet që janë të thirrura që drejtpërdrejt ta kryejnë atë, hezitojnë ta bëjnë një gjë të tillë. Ai theksoi se kur kemi të bëjmë me konflikt interesi të zyrtarëve të lartë publikë, është vërejtur një lloj spostimi i tyre në kuptim të asaj që pozitën e dytë këta zyrtarë vetëm e deklarojnë si të dorëhequr prej saj, por prapë mbeten pjesë e atij organizmi. Gjithashtu, ai theksoi se kur jemi tek deklarimi i pasurisë, pa dashur ta minimizoj rolin e saj, kohët e fundit është vërejtur një interesim i madh i të gjithë aktorëve në këtë çështje dhe duket sikur po zhvendoset vëmendja vetëm këtu dhe nuk po bëhet në drejtim më serioz në luftimin e korrupsionit. Ai, gjithashtu, parashtroi pyetjen se sa ka raportime për tenderë njëburimor, ngase shpërdorimi më i madh i parasë publike ekziston në nivelin e prokurimit.

Nezir Çoçaj, drejtori tri pyetje për përfaqësuesit e agjencisë: A ka agjencia takime të përbashkëta, në formë të rregullt, me institucione të tjera relevante që merren me luftimin e korrupsionit? Cili është bashkëpunimi i agjencisë me shoqërinë civile, të cilët përcjellin agjendat kundër-korrupsion? Çfarë duhet të jetë shtimi i kapaciteteve të agjencisë, konkretisht a është nevoja për staf të ri apo për trajnime profesionale të stafit ekzistues?

Agim Ademaj, parashtroi një pyetje, siç e quajti ai personale për drejtorin e agjencisë në lidhje me keqpërdorimet që bëhen në procedura të tenderëve, se çka mendon ai se si duhet vepruar për ta ndalë një gjë të tillë.

Donika Kadaj-Bujupi, parashtroi pyetje në lidhje me atë se sa garanton agjencia që mund të ushtrojë kontroll mbi pasuritë e zyrtarëve publikë. Në lidhje me këtë ajo parashtroi pyetjen: Gjatë ushtrimit të këtij kontrolli, a ka qasje agjencia në pasuritë e zyrtarëve publikë që janë jashtë vendit? Dhe pyetja e fundit ishte: A janë të dhënat statistikore të mjaftueshme për të kuptuar që lufta kundër korrupsionit po jep sukses?

Hasan Preteni, theksoi se sa i përket detajeve të raportit, kjo është bërë për arsye se vërejtjet që kanë qenë për raportin e fundit, kanë konsistuar pikërisht për këtë çështje, pra që të kemi më shumë detaje. Sa i përket pengesave që paraqiten në rrugën e agjencisë për luftimin e korrupsionit, të gjitha pengesat që janë paraqitur, dhe që do të paraqiten, janë bërë dhe do të bëhen publike, pa pasur nevojë që të presim për raportin vjetor. Sa i përket ndryshimeve në legjislacion, ne do nuk do të hezitojmë që t'i themi opinionet tona dhe kur jemi këtu, do të ishte

mirë që në Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit të sqarohet mirë çështja e dy e më tepër vendeve të punës, të harmonizohet me kodin penal, të sqarohet se çka kuptojmë me mos-pajtueshmëri dhe çka me konflikt të interesit, kush llogaritet të jetë person i besueshëm, dhe të gjitha këto, kanë qenë kërkesat tona të cilat nuk janë përkrahur. Sa i përket kontrollit dhe prejardhjes së pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë, nuk ka bazë ligjore për ta kontrolluar një gjë të tillë nga ana e agjencisë. Sa i përket pasurisë jashtë vendit, ai theksoi se ka pasur dy raste të tilla, dhe atë në Shqipëri, por me gjithë faktin se ekziston një memorandum mirëkuptimi në mes agjencisë dhe Inspektoratit të Shqipërisë, nuk na është mundur ta bëjmë një kontroll të tillë. Sa i përket mosdeklarimit të pasurisë, ai theksoi se për mendimin e tij personal, kjo nuk është dashtë të futet në kod penal, si dënim me burgim, por të shtohet masa e dënimit me gjobë. Sa i përket bashkëpunimit me shoqërinë civile, ai theksoi se janë të hapur si agjenci për bashkëpunim me të gjithë ata që reflektojnë pozitivisht dhe dëshirojnë të bashkëpunojnë, ndërsa sa i përket bashkëpunimit me institucione, ne e kemi obligim ligjor për ta bërë një gjë të tillë për luftimin e korrupsionit. Sa i përket konfliktit të interesit të z. Shala, procedura do të jetë publike dhe vendimi do të bëhet publik. Sa i përket rasteve të këshilltarit të Kryeministrit, që të dyja janë brenda afateve ligjore, ku iu është bërë e ditur konflikti dhe kanë 30 ditë që t'i shmangen asaj veprë. Sa i përket rastit të z. Stavileci, me Ligjin për parandalimin e konfliktit të interesit, ai nuk është në konflikt interesi. Bashkëpunimi me Prokurorinë e Shtetit ka filluar të rritet, edhe pse ndër vite kemi pasur raste të mospërgjigjes nga ana e tyre. Gjatë tri viteve të fundit, mund të themi se ka ngecje në gjykimin e korrupsionit. Ai kërkoi që të bëhen ndryshime në drejtim të ngritjes së pagave të zyrtarëve të agjencisë, ngase përveç drejtorit të tij, të gjitha të tjerët kanë paga të ulëta. Institucionet që kanë më së shumti korrupsion janë qeveria, pushteti lokal, ndërmarrjet publike dhe gjykatat. Sa i përket veprave korruptuese, problem është se nuk kemi arritur asnjëherë të provojmë qëllimin e tyre. Sa i përket largimit nga postet e bizneseve, ideja është që një zyrtar i lartë, pas emërimit në funksion të lartë publikë, duhet të largohet nga organet menaxhuese të ndërmarrjes, por jo të heqë dorë nga pronësia mbi të. Sa i përket prokurimit, edhe ne mendojmë se aty është shkalla më e lartë e korrupsionit, pra kemi të bëjmë me tenderomani.

Agim Aliu, theksoi se mbetet shqetësuese çështja e kuotës në procedurën për tender dhe se kjo është forma përmes të cilës më së shumti vije në shprehje korrupsioni, andaj ai kërkoi që agjencia ta marrë më me përgjegjësi këtë lloj të prokurimit publik.

Hasan Preteni, theksoi se plotësisht pajtohet me këtë që u tha nga z. Aliu, dhe se agjencia do të marrë më seriozisht këtë çështje, dhe se, pret që edhe Zyra e Rregullatorit të Prokurimit Publik ta bëjë një gjë të tillë.

Dorunitë Maloku, theksoi se përgjigja e drejtorit të agjencisë në pyetjen e saj se cili institucion prin për nga shkalla e korrupsionit, nuk ishte konkrete dhe se pret një përgjigje më konkrete.

Kryetarja, gjithashtu theksoi se nuk jeni përgjegjur në atë se a keni të drejtë në qasje të xhirollogarive bankare. Dhe pyetja tjetër ishte se pse ju si agjenci nuk kërkon nxjerrjen e Ligjit anti-mafia, pasi që ka problem me barrën e provës. Gjithashtu, ajo pyeti se a ka pasur presione nga ana e zyrtarëve të lartë publikë.

Armend Zemaj, parashtroi pyetjen: Cili është bashkëpunimi i agjencisë me OSHP-në?

Hasan Preteni, sa i përket institucioneve më të korruptuara, ju siguroj se me një kërkesë nga ana e Komisionit tuaj, ju do të keni listën me të gjitha institucionet e korruptuara. Sa i përket qasjes në xhirollogari, këtë të drejtë nuk e ka agjencia, por atë e bën vetëm institucioni që kryen hetime penale. Sa i përket presioneve, para janarit 2014 kanë qenë 2 raste, ndërsa në janar të atij viti, kanë qenë 5 persona që kanë ushtruar presion mbi zyrtarët e agjencisë. Ai tregoi gjithashtu për rolin që ka OSHP-ja dhe se është institucion mjaft fuqishëm, andaj ne vetëm ofrojmë opinion dhe ka tre raste kur ne kemi bërë ankesë ndaj vendimeve të këtij institucioni.

Kryetarja, pas diskutimeve dhe paraqitjes së raportit të AKK-së nga ana e drejtorit të saj, hodhi në votim raportin dhe konstatoi se: me 5 vota për, dhe 2 kundër, Komisioni nxori këtë

Rekomandim

Të shqyrtohet dhe të miratohet Raporti i punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, për vitin 2014.

5. Caktimi i një përfaqësuesi në Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish- të Dënuarve dhe të ish- të Përndjekurve Politikë

Komisioni, në bazë të nenit 62 të Rregullores së Kuvendit dhe nenit 19 të Ligjit 03/095 për të drejtat e ish- të dënuarve dhe të përndjekurve politikë, diskutoi për zëvendësimin e anëtarit në Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish- të Dënuarve dhe të ish- të Përndjekurve Politikë, dhe lidhur me këtë, me 5 vota për, mori

V E N D I M

Deputetja Doruntinë Maloku caktohet anëtare në Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish- të Dënuarve dhe të ish- të Përndjekurve Politikë, në vend të ish- deputetit Halit Krasniqi.

6. Votimi i raportit me rekomandime për Raportin e punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, për vitin 2014

Kryetarja konstatoi se Komisioni me shumicë votash, nxori këtë

Rekomandim

- I. Të shqyrtohet dhe të miratohet Raporti i punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, për vitin 2014.
- II. I rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës, që me rastin e rishikimit të buxhetit për vitin 2015, të ndajë buxhet shtesë për Agjencinë për Ndihmë Juridike Falas.
- III. I rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës që Agjencia për Ndihmë Juridike Falas të vendoset në objektet publike.
- IV. Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, brenda vitit 2015, t'ia dërgojë Komisionit një raport lidhur me numrin e lëndëve të përfaqësuara në gjykata dhe lëndëve të vendosura në favor të palëve të përfaqësuara, që nga themelimi i Agjencisë.

Mbledhja përfundoi në orën 13:10.
E përgatiti:
Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Albulena Haxhiu
